



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.288/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj, kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Shefqet H Osmani, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 22.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

- I. **HEDHET e palejuar** (pasafatshshme), ankesa respektivisht dispozitivi nën I i ankesës ZL. Anr.288/2025 e datës 21.10.2025 parashtruar nga Shefqet H Osmani, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.
- II. **REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa përkitazi dispozitivi nën II i ankesës ZL. Anr.288/2025 e datës 21.10.2025 parashtruar nga Shefqet H Osmani, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025

A r s y e t i m

Me datë 21.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Shefqet H Osmani, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, në të cilën thekson se në Qendrën e votimit 1924/01 në SHFMU "Ilmi Rakovica" në Prishtinë i mungojnë 23 vota të familjarëve të afërt nga gjithsej 25 familjar në raportin e numërimit rezultojnë vetëm 2 vota, ndërsa votat e diasporës të cilat vijnë nga Finlanda, Franca, Suedia e të cilat i ka dëshmi zarfin postar thekson se i mungojnë në raportin e numërimit.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se me datën 03.09.2025, KQZ ka miratuar Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime. Në faqen 14 të kësaj procedure shpjegohet mënyra e vlerësimit të pakove me fletëvotime, ndërsa pas përfundimit të procesit të verifikimit të zarfeve me fletëvotime, DSHV dorëzon

në QNR listën e votuesve të cilët kanë votuar përmes postës dhe zarfet me fletëvotime të ndara në kuti sipas komunave të votuesve. (Shih të bashkëngjitur Procedurën Standarde të Veprimit për Votimin Jashtë Kosovës dhe Vlerësimin e Pakove me Fletëvotime).

Bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 1 Z Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa në nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Procesi i numërimit të votave në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) është zhvilluar në përputhje me Rregulloren Zgjedhore Nr. 14/2024, Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) ku ekipet e numërimit kanë bërë numërimin e votave të kandidatëve në transparencë të plotë, ku fletëvotimi është prezantuar në ekran dhe është parë nga vëzhguesit e akredituar. Krahas fletëvotimeve, në ekran është prezantuar edhe pamja e sistemit elektronik ku figurojnë numrat e kandidatëve të cilët regjistrohen në sistem.

Rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimi me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZAP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga, KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, mund të ushtrojnë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP.

Sa i përket pikës së parë të ankesës së palës, lidhur me dyshimet për mungesë të votave në vendvotimin 1924/01, pas analizimit të lëndës është vërejtur se pala ankuese ankesën e ka paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sepse pas konfirmimit të ZEKKZ në komunën e Prishtinës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 18.10.2025, në ora 23:50, ndërsa pala ankesën e ka parashtruar me datën 21.10.2025. Pra nuk është brenda afatit ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Sa i përket pretendimeve të palëve ankuese që mbështeten në deklaratimet e personave, dhe familjareve të tij, duhet theksuar se, në kuptim të nenit 4 paragrafi 1,3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Publikimi i votës cenon këtë parim dhe shpërfaq vullnetin e votuesit. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese, nuk ka bashkëngjitur prova relevante që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e tij.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se ankesa sa i përket pikës nën I është e palejuar, ndërsa sa i përket pikës II është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën (përkatësisht pikën I të saj) e Shefqet H Osmani, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë janë parashtruar pas afatit të parapare ligjor.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 21.10.2025, ku ka pretenduar se në Qendren e Votimit me numer 1924/201 ne raportin e numrimit rezulton se i mungojne 23 vota. Lidhur me kete pretendim te ankuesit per dyshim se i mungojne 23 vota, paneli ka gjetur se pala ankuese ankesen e ka parashtruar jashte afatit ligjor për parashtrimin e ankeses, sepse pas konfirmimit ne ZEKKZ ne Komunen e Prishtines aktiviteti i QKN është përmbyllur me date 18.10.2025 ne ora 23:50, ndersa pala ankesen e paraashtruar me datë 21.10.2025. Pra nuk është paraqitur brenda afatit prej 48 oreve nga shkelja supozuar ashtu siq e parasheh neni 105 paragraf 1 LZP-se.

Nga se neni 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton *“Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar”*.

Neni 9, paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se *“Personi mund te paraqesë ankese në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR,”*

Neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh që: *“PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.”*

Ndërsa pretendimi te ankuesit për votat e diasporës (të cekura në pikën II të ankesës) të cilat vijnë nga Finlanda, Franca, Suedia, ku thekson se i mungojnë në raportin e numërimit, Paneli sqaron se bazuar në nenin 17 të Rregullores Zgjedhore nr. 17/2024 për Regjistrimin dhe Votimin Jashtë Kosovës parashihet numërimi i fletëvotimeve të dërguara me postë, sipas të cilës: 1 Z Fletëvotimet që janë dërguar përmes postës dhe fletëvotimet që janë hedhur në kutitë e votimit nga procesi i votimit në përfaqësinë diplomatike, numërohen në QNR. Ndërsa ne nenin 20 të Rregullores Zgjedhore nr. 14/2024 për Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve, parashihet procedura numërimit të fletëvotimeve në QNR, përkatësisht, në paragrafin 9 të nenit 20 parashihet se: Zarfet e votimit me postë hapen dhe numërohen pas përfundimit të krahasimit të listave votuese të përcaktuara në nenin 18 të kësaj rregullore si dhe pas përfundimit të numërimit të votave në përfaqësi diplomatike.

Sa i përket pretendimeve te palës ankuese qe mbështeten ne deklarin e disa personave – familjareve, sipas vlerësimit te panelit e bazuar ne nenin 4 paragraf 1.3 te LZP, liria dhe fshehtësia e votës janë te garantuara, gjer sa shpërfaqja e vullnetit te votuesve ne parim cenon fshehtësinë votës.

Andaj Paneli vlerësoi se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur veprime që kane shkelur të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa gjegjësisht pjesa e dyte është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, apo mbështetjen-në pohimet të qytetarëve (votuesve), me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, lidhur me pikën II të ankesës nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nën përcaktohet se *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, nenit 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3 të Rregullës 01/2025, paneli vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.288/2025 datë 22.10.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.